

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Haxhi Shala nga Prishtina, për kundërvajtje nëni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe nëni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtaresve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare, e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe konform nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 24.05.2012 merr këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET: Procedura kundërvajtëse ndaj Haxhi Xheladin Shala, i lindur me 17.08.1970 në Bajë të Mlisheves, tani jeton në Prishtinë në Rr. Dardania Rr. Xhemail Mustafa Ll. A nr. 40, i punon Drejtor për Politika dhe Plane në Ministrinë Forcës dhe Sigurisë në Prishtinë, i martuar baba i dy fëmijëve, fakultetin e kryer, i gjendjes së mesme ekonomike për kundërvajtjen nga nëni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe nëni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtaresve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare

Procedura Pezullohet konform nenit 198 par. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit të kërkesës.

DPK/DMP

03-1413/13

04

15.05.2013

Arsyetim

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtror kësaj gjykate kërkesën Nr. 01 1599/2012 me dt. 02.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit Haxhi Shala për kundërvajtjen nga nëni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe nëni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtaresve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare, me të cilën kërkesë i vihet në barë se në Agjencinë Kundër Korrupsionit nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri me dt. 31 mars 2012.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili e deklaroi se nuk e pranon kundërvajtjen e cila i vihet mbi barë, duke dëshmuar se nga data 06.01.2012 deri me 31.03.2012 ka qenë në Britani të Madhe për të ndjekur një trajnim të Gjuhës Angleze.

Në bazë të dhënave nga fletëparaqitja, deklaratës së të pandehurit me të cilën u vërtetua se këto prova si: Vendimin e Ministrisë FSK-se me të cilën Haxhi Shala ka fituar të drejtën për të ndjekur trajnimin në Britani të Madhe, kopjen e pasaportës, dokumentet mbi akomodimin, tikitën e udhëtimit, pastaj dokumentin e dt. 27.2012 me të cilën ehte njoftuar AAK se i pandehuri gjendet jashtë vendit, dokumenti me të cilin pas kthimit në Kosovë ka përmbushur obligimin të deklaruar pasurinë si dhe shqimit të shkresave të lëndës, u vërtetua se ndaj të pandehurit nuk ka prova se ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet mbi barë.

Gjykata e Pezulloi procedurën kundërvajtëse ndaj të Haxhi Shales, konform nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet

U VENDOS NE GJYKATEN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. Regj 14817/12 me dt. 24.05.2012

Gjyqtarja

Lindita Jaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtror Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.